



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.20/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ të paditësit NN “A...” me seli në Mitrovicë, Rr. “...” pn, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti 4,246.96€, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur me datë 13.09.2022, në prani të paditësit-pronarit F.H personalisht e mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit NN “A...” me seli në Mitrovicë, Rr. “...” pn, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI Aktvendimi nr.374/2019 i datës 26.09.2019, i Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi me padinë e parashtruar në gjykatë me datë 30.10.2019 ka iniciuar konflikt administrative kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës për anulimin e vendimit nr.374/2019 të datës 26.09.2019 për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Tutje deklaroi se paditësi ka pranuar Vendimin e Avokatit të Popullit

nr, ZQ- ... lidhur me refuzimin për ulje dhe heqje të ndëshkimeve, të lëshuara nga Zyra Qendrore e ATK-së, dhe brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë në ATK- Divizioni i Ankesave në Prishtinë për shkak të mos aplikimit të dispozitave të Ligjit të procedurës së përgjithshme administrative, Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. E paditura në vendimin kontestues nuk ka komentuar mos aplikimin e dispozitave të Ligjeve në fuqi, nuk ka dhënë arsyen pse shuma e cekur nuk mund të aprovet edhe pse nga ana e paditësit janë dhënë arsyet të cilat është dashur të pranohen si të bazuara. E paditura vendimin e vet e ka mbështetur në nenin 43 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 i cili parasheh “shkakun i arsyeshëm mbështetet në faktet dhe rrethanat në situatë të veçantë dhe mundëson që ATK-ja të ofroj lehtësime nga ndëshkimet që janë vlerësuar. lehtësimet për shkak të arsyeshëm përgjithësisht jepen kur tatimpaguesi ushtron kujdes dhe maturë të zakonshme afariste në kryerjen e detyrimeve të tij”. Në seancën e shqyrtimit kryesor paditësi-pronari personalisht konsideron se i është bërë e padrejtë kur i është shqiptuar ndëshkimi në fillim, për shkak se i njëjti ka paraqitur vullnetarisht korrigjimin pranë të paditurës, dhe në bazë të nenit 62 të Ligjit Nr.03/L-222, në rastet kur tatimpaguesi vullnetarisht paraqet plotësimin apo korrigjimin e deklaratave tatimore para fillimit të inspektimit, dënimi në këto raste është maksimumi 25 % nga ndëshkimi që do të dilte nga një kontroll i rregullt nga të gjeturat e vet ATK-së. Po ashtu, sipas këtij neni pika 2 dhe 3 kur kryhen në kohë të gjitha detyrimet tatimore, sanksioni financiar do të jetë në masën vetëm 2% nga detyrimi tatimor. Tutje pronari i paditësit e njofton gjykatën se i ka përmbushur të gjitha detyrimet tatimore në shumën prej 32,206.48€, shumë kjo e cila nuk është kontestuese në këtë lëndë të konfliktit administrativ. Meqë në petitumin e padisë janë lëshuar disa gabime teknike, bën precizimin e të njëjtës, ashtu që i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr këtë aktgjykim me të cilin aprovet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, anulohet pjesërisht vendimi kontestues nr.347/2019 i datës 26.09.2019, dhe atë vetëm për shumën e ndëshkimit prej 4,246.96€ dhe obligohet e paditura që të zvogëloj ndëshkimet nga shuma prej 4,246.96€ në masën 98 %, ashtu siç përcaktohet me nenin 62 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-222, si dhe të paguajë kamatën ndëshkuese prej 8 %, nga vlera e 4,246.96€, nga dita e pagesës së ndëshkimit, ndërsa

shpenzimet mbesin sipas pikës IV të petitumit të kërkesëpadisë. Shpenzimet e procedurës i kërkon.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 02.10.2020 i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si ta pabazuara në ligj dhe në fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së nr.347/2019 i datës 29.07.2019 është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës. ATK-ja ka vlerësuar se tatimpaguesi nuk i plotëson kriteret për falje të ndëshkimeve sipas nenit 62 paragrafi 3 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sepse i njëjti nuk ka arritur të dëshmoj shkaqe të arsyeshme, besim të mirë, vështirësi të mëdha apo ndonjë arsye tjetër e cila do të rriste efektivitetin e ATK-së dhe po ashtu është vlerësuar se tatimpaguesi nuk ka pasur kujdes dhe maturi të zakonshme afariste, andaj me të drejtë është vlerësuar se i njëjti nuk i plotëson kriteret për heqje të ndëshkimeve sipas nenit 62 paragrafi 3 të ligjit 03/L-222, nenit 43 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222. ATK-ja duke u bazuar në rekomandimet e aktgjykimit A.nr. ... të Gjykatës Themelore Prishtinë, vlerëson se paditësit i është aprovuar ankesa pjesërisht sa i përket kërkesës për heqje të ndëshkimeve sipas nëntit 62 paragrafi 1 të Ligjit 03/L-222 i cili parasheh “Në rastin kur tatimpaguesi i cili i nënshtrohet një ose më tepër sanksioneve të parashikuara në nenet 50-61 të këtij ligji informon vullnetarisht ATK-në, pasi që tatimpaguesi së pari njoftohet lidhur me inspektimin, sanksioni maksimal financiar do të jetë në masën pesëdhjetë përqind e sanksionit që zbatohet. Pra paditësi nuk ka arritur të dëshmoj të kundërtën e vlerësimit tatimor me prova materiale as gjatë procedurës së ankesës bazuar në paragrafin 6 të nenit 19 të ligjit 03/L-222. ATK i propozon gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësit duke vërtetuar vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.347/2019 datë 26.09.2019.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ komfor dispozitave të nenit 41 të LKA-së për arsye se pala e paditur përmes parashtresës së datës 09.09.2022 e ka njoftuar gjykatën se nuk mund të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të veprohet konform nenit 38 paragrafi të LKA-së (provë: Parashtresa e datës 09.09.2022 nga ATK).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 13.09.2022, ka administruar provat dhe atë: Vendimet 347/2019 i datës 26.09.2019, 300/2014 i datës 15.08.2014, 463/2018 i datës 05.12.2018, Ankesat e ushtruara në ATK e datës 19.07.2019, 31.07.2014, Përgjigja në padi e datës 02.10.2020, Kërkesa për heqjen e ndëshkimeve e ushtruar në ATK, e datës 29.05.2014, Vendimet 03-6-26/4 i datës 07.07.2014, 03-06-2582 i datës 18.06.2019, Kërkesa për rregullimin e ndëshkimit e datës 16.05.2019,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Departamenti i Ankesave-ATK, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit ku në dispozitivin II të aktvendimit ka ndryshuar pjesërisht Njoftim Vlerësimet e tatimit në të Ardhura të Korporatave për vitin 2010, 2011, 2012 dhe 2013 sa i përket aplikimit të ndëshkimeve sipas nenit 51, duke zvogëluar ndëshkimet në masën 50% të sanksionit komfor nenit 62.1 të ligjit nr.03/L-222, ku në total ndëshkimet janë zvogëluar në vlerë prej 4,246.96€. Në vendimin kontestues e paditura ka vepruar sipas rekomandimeve të aktgjykimit A.nr.1756/14 të datës 13.09.2018, me të cilin aktgjykim është aprovuar padia e paditësit dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të e paditura, ashtu që i është rekomanduar të paditurës që të ketë parasysh dispozitat ligjore të nenit 62 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Gjykata konstaton se e paditura në vendimin kontestues i ka zbatuar në përpikëri rekomandimet e gjykatës të dhëna përmes aktgjykimit A.nr.1756/14 të datës 13.09.2018, me ç'rast duke u mbështetur në dispozitat e nenit 62, përkatësisht të paragrafin 1 të këtij nenin, ka bërë edhe zbritjen e ndëshkimeve pesëdhjetë përqind (50%).

Nga kjo gjendej faktike gjykata e konsideron të pabazuar pretendimin e paditësit se në paragrafin 2.3 të nenit 62 të Ligjit 03/L-222 parashihet se kur kryhen me kohë të gjitha detyrimet tatimore sanksioni financiar do të jetë në masën 2% nga detyrimi tatimor, për arsye se këto dispozita vlejnë vetëm për rastet kur tatimpaguesi me detyrim tatimor të pashlyer, hyn në marrëveshje me shkrim për të paguar tatimin e pashlyer me dy ose më tepër këste, i përmbush kushtet e marrëveshjes me shkrim dhe i kryen në kohë të gjitha detyrimet e tjera tatimore gjatë kohës së asaj marrëveshjeje gjë që në rastin konkret nuk janë paraqitur dëshmi lidhur me këto veprime që në mënyrë kumulative të jenë përmbushur nga këtu paditësi dhe për më tepër kjo dispozitë i referohet vetëm rasteve në lidhje me dorëzimin dhe pagesën e vonuar sipas nenit 51 të këtij Ligji 03/L-222.

Pretendimi tjetër i paditësit se e paditura mbështetur në paragrafin 1 të nenit 62 të Ligjit 03/L-222 është dashur që të bëjë uljen e ndëshkimit me 25% e jo me 50% siç ka vepruar, për arsye se paditësi vet e ka deklaruar obligimin tatimor pa pasur njoftim për kontroll nga ATK-ja, gjykata iu referua dispozitave të Ligjit 03/L-222, neni 62, i cili taksativisht në paragrafin 1, parasheh se *“Në rastin kur tatimpaguesi i cili i nënshtrohet një ose më tepër sanksioneve të parashikuara në nenet 50 deri 61 të këtij ligji, vullnetarisht informon ATK për detyrimin e tij, përpara se së pari të jetë njoftuar për një inspektim tatimor të mundshëm nga ATK, i cili do të mund zbulohej nga ATK, sanksioni maksimal financiar i mundshëm do të jetë njëzetepesë përqind (25%) i sanksionit që do të zbatohej përndryshe. Në rastin kur tatimpaguesi informon vullnetarisht ATK-në pasi tatimpaguesi së pari njoftohet lidhur me një inspektim tatimor të mundshëm, por përpara se ATK të fillojë këtë inspektim, sanksioni maksimal financiar do të jetë në masën pesëdhjetë përqind (50%) të sanksionit që do zbatohej përndryshe”*. Tutje paragrafi. 3. I këtij neni shprehimisht përcakton se *“Nëse personi obligues për ndonjë tatim dëshmon shkaqe të arsyeshme, besim të mirë, vështirësi të madhe ose arsye të tjera të cilat do të ngritin efektivitetin e ATK-së, ATK-ja mund të zvogëlojë ose heq çdo ndëshkim të vlerësuar, apo propozuar, në baza sipas rastit”*. Gjukata nga interpretimi i drejtë i këtyre dispozitave ligjore vlerëson se është obligim ligjor i këtu paditësit që në mënyrë kumulative të dëshmojë shkaqe të arsyeshme, besim të mirë, vështirësi të madhe ose arsye të tjera të cilat do të ngritin efektivitetin e ATK-së, në mënyrë që pastaj e paditura ATK-ja të mund të zvogëlojë ose heq çdo ndëshkim të vlerësuar, apo

propozuar, në baza sipas rastit, mirëpo edhe përkundër kësaj pra edhe përkundër faktit se këtu paditësi vetëm e ka përmendur bazën ligjore i njejtë nuk ka bashkangjitur asnjë provë që dëshmon ndonjë nga veprimet si më lartë kundrejt këtu të paditurës, derisa në anën tjetër kjo e fundit pra e paditura me vendimin kontestues ka ulur ndëshkimet në masën 50%, pasi që fillimisht ka konstatuar se këtu paditësi vullnetarisht ka informuar të paditurën ATK-ë, por vetëm pasi që tatimpaguesi këtu paditësi është njoftuar lidhur me një inspektim tatimor të mundshëm nga e paditura, por përpara se ATK-ë të fillojë këtë inspektim, andaj edhe e drejta materiale në këtë rast nga e paditura është zbatuar në mënyrë të rregullt, sepse në këto raste aplikohet pasuesi i dytë i nenit 62, par 1, të Ligjit 03/L333, i cili nën shprehimisht thekson se *“Në rastin kur tatimpaguesi informon vullnetarisht ATK-në pasi tatimpaguesi së pari njoftohet lidhur me një inspektim tatimor të mundshëm, por përpara se ATK të fillojë këtë inspektim, sanksioni maksimal financiar do të jetë në masën pesëdhjetë përqind (50%) të sanksionit që do zbatohet përndryshe”*

Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi kontestues i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, pasi që sipas këtij neni në konflikt administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.20/22 datë 13.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

---

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

---

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.